


Materiali në vijim është një analizë e hollësishme e punës dhe aktivitetit të Inspektoratit Shtetëror Shëndetësor (ISHSH) gjatë vitit 2018. Në këtë analizë janë përfshirë arritjet e ISHSH gjatë vitit 2018, praktikat e mira inspektuese, gjetjet dhe problematika e hasur gjatë këtyre inspektimeve.

Inspektorati Shtetëror Shëndetësor është krijuar në bazë të Ligjit Nr. 10 433, datë 16.06.2011 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, dhe me Vendim të Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë Nr. 241, Nr. prot. 949 datë 27/03/2013.



Misioni i Inspektoratit Shtetëror Shëndetësor është: “Garantimi i respektimit të kërkesave ligjore në fushën e shëndetit publik”.

Zbatimi i planit të vitit 2018 është bërë duke pasur në mendje krijimin dhe funksionimin e një institucioni që i përgjigjet kërkesave të popullatës për një administratë publike në shërbim të tyre. Gjithashtu zbatimi i planit të vitit 2018 është edhe rezultat i një procesi të frytshëm bashkëpunimi me strukturat egzistuese të Ministrisë së Shëndetësisë duke u bazuar në përvojën më të mirë të tyre në vite. Gjatë vitit 2018 strukturat e ISHSH në qarqe dhe ai qendror kanë kryer në total 25 705 inspektime dhe ri-inspektime në të gjithë territorin e vendit në respektim të kërkesave ligjore në fushën e shëndetit publik.

Në momentet kryesore të inspektimeve të vitit 2018 mund të përmenden:

- Inspektimet higjieno sanitare të institucioneve arsimore, parashkollore, shkollore, universitare, menceve dhe konvikteve në funksion të këtyre institucioneve.
- Inspektimet e spitaleve publike dhe jopublike,
- Inspektimi dhe monitorimi shëndetësor dhe higjieno sanitar para fillimit dhe gjatë sezonit turistik në zonat turistike;
- Inspektimet e bëra për zbatimin e ligjit Nr. 9928, i ndryshuar, “Për shërbimin shëndetësor stomatologjik”
- Inspektimet e bëra për zbatimin e ligjit Nr. 8528, i ndryshuar “Për nxitjen dhe mbrojtjen e të ushqyerit me gji”;
- Inspektimet e bëra për klinikat mjekësore publike dhe jo publike;
- Inspektimet për zbatimin e ligjeve “Për mbrojtjen nga rrezatimi jonizues dhe jo-jonizues”
- Inspektimet e ndërmarrjeve për kujdesin dhe sigurinë e shëndetit në punë,
- Inspektimet e institucioneve shëndetësore prodhuese të mbetjeve spitalore,
- Inspektimet e vazhdueshme për zbatimin e ligjit “Për mbrojtjen e shëndetit nga produktet e duhanit” dhe ligjin “Për mbrojtjen e të miturve nga përdorimi i alkoolit”

## HYRJE

Ky raport hartohet sipas kërkesave të ligjit Nr. 10433, dt. 16. 06. 2011 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë” dhe Urdhërit Nr. 7, dt. 19. 02. 2015 të Inspektoratit Qendror, dhe përmbledh aktivitetin dhe arritjet e Inspektoratit Shtetëror Shëndetësor gjatë vitit 2018.

Misioni i Inspektoratit Shtetëror Shëndetësor është: “Garantimi i respektimit të kërkesave ligjore në fushën e shëndetit publik”.

Inspektorati Shtetëror Shëndetësor është përgjegjës për të gjitha funksionet e inspektimit të ministrisë përgjegjëse për shëndetësinë, me përjashtim të inspektimit të veprimtarive në fushën farmaceutike, i cili kryhet nga struktura përgjegjëse sipas legjislacionit në fuqi.

Inspektorati Shtetëror Shëndetësor në përmbushje të detyrimeve ligjore, synon arritjen e këtyre objektivave:

- Të rrisë sigurinë e produkteve dhe shërbimeve që ofrohen në fushën e shëndetësisë, me përjashtim të inspektimit të veprimtarive në fushën farmaceutike i cili kryhet nga struktura përgjegjëse sipas legjislacionit në fuqi.
- Të ofrojë transparencë dhe metoda sa më bashkëkohore për kryerjen e kontrolleve nëpërmjet mbështetjes së ofruar nga një staf i përgatitur inspektorësh.
- Të krijojë një system të brendshëm alarmi të shpejtë për të arritur në një gjurmueshmëri të plotë të të gjitha produkteve dhe mallrave brënda fushës që ai mbulon.
- Të ndërgjegjësojë subjektet e inspektimit për masat që duhen marrë për përmirësimin e aktivitetit të tyre në kuadër të legjislacionit në fuqi në lidhje me sigurinë shëndetësore, duke synuar plotësimin e kushteve që kërkohet të arrihen për integrimin European.
- Të mbrojë konsumatorët shqiptarë në mënyrë efektive nga risqet dhe kërcënimet në fushën e shëndetësisë.
- Të ndërgjegjësojë operatorët e biznesit shqiptarë dhe konsumatorëve lidhur me praktikën e mira të higjienës shëndetësore që duhet të aplikohen në të gjithë fushën e aktivitetit të ISHSH.

Inspektorati Shtetëror Shëndetësor në përmbushje të detyrimeve ligjore, kryen:

- Bashkërendimin dhe koordinimin efikas të veprimtarisë në fushat të cilat janë në kompetencë të ministrisë përgjegjëse për shëndetësinë, duke përjashtuar inspektimin e veprimtarive në fushën farmaceutike;
- Sigurimin dhe unifikimin e praktikave më të mira të inspektimit, në shkallë vendi;
- Bashkërendimin e veprimtarisë së laboratorëve dhe sigurimin e kryerjes së analizave nga laboratorët akredituar.
- Informimin e publikut për veprimtarinë e inspektimit;
- Dhënien e mbështetjes teknike dhe administrative për veprimtarinë e inspektimit;
- Përgatitjen e programit dhe raportit vjetor të Inspektimit.

Inspektorati Shtetëror Shëndetësor ka objekt të punës së tij:

- Identifikimin e rreziqeve në të gjithë vendin dhe kërcënimet nga aktivitetet e paligjshme.
- Kryerjen e inspektimeve në kohë dhe me saktësi si dhe ato të përbashkëta sipas programit vjetor.
- Zhvillimin e zgjidhjeve inovative për të zbutur rreziqet dhe kërcënimet.
- Dhënien e informacionit në kohë dhe cilësi për vendimmarrësit.
- Vlerësimin e kontrolleve të brendshme dhe përmirësimeve që mbështesin zbatimin e suksesshëm të veprimtarisë së ISHSH.


Inspektorati Shtetëror Shëndetësor drejtohet nga Kryeinspektori. Kryeinspektori është titullari i institucionit, i cili, në kuadër të funksioneve dhe detyrave të Inspektoratit Shtetëror Shëndetësor ushtron kompetencat e tij.

ISHSH organizohet në dy nivele: Në nivel qendror dhe atë rajonal për çdo qark të vendit.

ISHSH qendror drejtohet nga Kryeinspektori. Kryeinspektori është titullari i institucionit, i cili në kuadër të funksioneve dhe detyrave të Inspektoratit Shtetëror Shëndetësor është përgjegjës për organizimin dhe koordinimin e funksionimit si dhe për cilësinë dhe efektivitetin e veprimtarisë së ISHSH.

ISHSH në nivel qendror përbëhet nga:

- Kryeinspektori;
- Sektori i Koordinimit dhe Monitorimit të Inspektimit;
- Sektori Juridik dhe i Hartimit të Proçedurave të Inspektimit;
- Sektori i Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse.



ISHSH rajonale drejtohen nga kryeinspektorët rajonalë. Kryeinspektori rajonal përfaqëson degën rajonale në marrëdhënie me të tretët në nivelin e qarkut përkatës dhe është përgjegjës për organizimin e funksionimit si dhe për cilësinë dhe efektivitetin e veprimtarisë së degës së tij.

ISHSH në nivel rajonal përbëhet nga:

- Titullari i degës Rajonale/Kryeinspektor;
- Sektori i Inspektimit Sanitar;
- Sektori i Inspektimeve të tjera Shëndetësore;
- Sektori Juridik;
- Sektori i Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse.



## QËLLIMI DHE METODOLOGJIA

### QËLLIMI

- Për të shtuar vlera për ISHSH te palët e interesuara nëpërmjet një niveli sa më të lartë menaxhimi, për të përmbushur pritshmëritë dhe nevojat;
- Identifikimi i rreziqeve në të gjithë vendin dhe kërcënimet nga aktivitetet e paligjshme;
- Kryerjen e inspektimeve në kohë dhe me saktësi, si dhe ato të përbashkëta sipas programimit vjetor;
- Zhvillimin e zgjidhjeve inovative për të zbutur rreziqet dhe kërcënimet;
- Dhënia e informacionit në kohë dhe cilësi për vendimmarrësit;
- Vlerësimi i kontrolleve të brendshme dhe përmirësime që mbështesin zbatimin e suksesshëm të veprimtarisë së ISHSH.

### METODOLOGJIA

Metodologjia e përdorur në këtë raport bazohet në programin e inspektimit i cili është instrumenti që përdor inspektorati shtetëror për planifikimin e akteve të inspektimit, me qëllim kontrollin për verifikimin e respektimit të kërkesave ligjore nga subjekti i inspektimit. Raporti është bazuar në aktet e inspektimit, memot përfundimtare të përgatitura në përfundim të cdo inspektimi.

# **1. INSPEKTORATI SHTETËROR SHËNDETËSOR GJATË VITIT 2018**

## **1.1. SEKTORI I INSPEKTIMIT**

1.1.1. SEKTORI I KOORDINIMIT DHE MONITORIMIT TË INSPEKTIMIT (ISHSH QENDROR)

1.1.2. SEKTORI I INSPEKTIMIT SANITAR (ISHSH RAJONAL)

1.1.3. SEKTORI I INSPEKTIMEVE TË TJERA SHËNDETËSORE (ISHSH RAJONAL)

## **1.1. SEKTORI I INSPEKTIMIT**

### **1.1.1. SEKTORI I KOORDINIMIT DHE MONITORIMIT TË INSPEKTIMIT (ISHSH QENDROR)**

Sektori i Koordinimit dhe Monitorimit të Inspektimit është struktura përgjegjëse për koordinimin, inspektimin dhe raportimin e realizimit të Programit të Inspektimit zyrtar të kryer në të gjithë vendin të përcaktuar në vijim të rregullores. Sektori bashkëpunon me degët rajonale, për çështje dhe praktika që kanë të bëjnë me mbarëvajtjen e punës në zbatimin e programeve të inspektimit në përputhje me legjislacionin në fuqi në fushën e shëndetësisë si dhe me Procedurat standarte të inspektimit referuar objektivave të ISHSH, Sektori i Koordinimit dhe Monitorimit të Inspektimit ka për qëllim të realizojë detyrat në përputhje me ligjet dhe aktet nënligjore në fuqi, duke përdorur me efikasitet burimet njerëzore. Inspektorët e Sektorit të Koordinimit dhe Monitorimit të Inspektimit kryejnë detyrat e tyre në mbështetje të nenit 119 të Kushtetutës së Shqipërisë, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, të nenit 29, të pikës 2 të ligjit nr. 90/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, të ligjit nr. 10433, datë 16.6.2011 “Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, dhe të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 241, datë 27.03.2013 “Për organizimin dhe funksionimin e Inspektoratit Shtetëror Shëndetësor”, Urdhërit Nr. 163, datë 19.05.2014 të Kryeministrit të Shqipërisë “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Inspektoratit Shtetëror Shëndetësor”.

Inspektorët e Sektorit të Koordinimit dhe Monitorimit të Inspektimit kryejnë detyrat e tyre në mbështetje të nenit 119 të Kushtetutës së Shqipërisë, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, të nenit 29, të pikës 2 të ligjit nr. 90/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, të ligjit nr. 10433, datë 16.6.2011 “Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë” dhe të VKM nr. 241, datë 27.03.2013 “Për organizimin dhe funksionimin e Inspektoratit Shtetëror Shëndetësor”, Urdhërit Nr. 163, datë 19.05.2014 të Kryeministrit të Shqipërisë “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Inspektoratit Shtetëror Shëndetësor”.

Sektori i Koordinimit dhe Monitorimit të Inspektimit përbëhet nga:

Përgjegjësi i sektorit

- 1 (një) Inspektor për inspektimin sanitar;
- 1 (një) Inspektor për inspektimin ambulator;
- 1 (një) Inspektor për inspektimin e burimit të rrezatimit;
- 1 (një) Inspektor për inspektimin stomatologjik;
- 1 (një) Inspektor për inspektimin spitalor;
- 4 (kater) Inspektorë për inspektime të tjera.

Inspektorët e Sektorit të Koordinimit dhe Monitorimit të Inspektimit:

- Hartojnë programet e inspektimit vjetorë dhe mujorë për fushën specifike që mbulon cdo inspektor dhe ia paraqesin përgjegjësit të sektorit për miratim.
- Kontrollonjë dhe përmirësojnë planet afatshkurtëra që paraqesin inspektoriatet rajonale dhe ja paraqesin përgjegjësit të sektorit të koordinimit dhe monitorimit të inspektimeve për miratim.
- Monitorojnë dhe kontrollojnë veprimtarinë inspektuese të inspektorateve rajonale, përmbushjen e detyrave sipas planit të punës të miratuar nga ISHSH në nivel qendror.
- Përgatitin raportin për programin vjetor dhe mujor të inspektimeve të kryera nga degët rajonale dhe ja paraqesin përgjegjësit të sektorit të koordinimit dhe monitorimit të inspektimeve.
- Kryejnë inspektime të drejtpërdrejta ndaj subjekteve të mëdha të inspektimit dhe atyre që kryejnë veprimtari me rrezikshmëri të lartë për shëndetin.
- Japin asistencë teknike dhe administrative për veprimtarinë e inspektimit.
- Sigurojnë praktika të unifikuara të inspektimit në shkallë vendi.
- Mbikqyrin zbatimin e ligjit të inspektimit për programimin, autorizimin dhe kryerjen e procedimit të inspektimit.

### **1.1. 2. SEKTORI I INSPEKTIMIT SANITAR (ISHSH RAJONAL)**

Sektori i Inspektimit Sanitar është struktura përgjegjëse për inspektimin dhe realizimin e programit të inspektimit vjetor të hartuar nga ISHSH Qendror. Sektori bashkëpunon me sektorët e tjerë për çështje dhe praktika që kanë të bëjnë me mbarëvajtjen e punës në zbatimin e programeve të inspektimit në përputhje me legjislacionin në fuqi në fushën sanitare si dhe me procedurat standarte të inspektimit referuar objektivave të ISHSH Rajonal, Sektori i Inspektimit Sanitar ka për qëllim të realizojë detyrat në përputhje me ligjet dhe aktet nënligjore në fuqi, duke përdorur me efikasitet burimet njerëzore.

Sektori i Inspektimit Sanitar përbëhet nga:

Përgjegjësi i sektorit

Inspektorë sanitarë

### **1.1.3. SEKTORI I INSPEKTIMEVE TË TJERA SHËNDETËSORE (ISHSH RAJONAL)**

Sektori i Inspektimeve të tjera Shëndetësore është struktura përgjegjëse për inspektimin dhe realizimin e programit të inspektimit vjetor të hartuar nga ISHSH Qendror. Sektori bashkëpunon me sektorët e tjerë për çështje dhe praktika që kanë të bëjnë me mbarëvajtjen e punës në zbatimin e programeve të inspektimit në përputhje me legjislacionin në fuqi në fushën sanitare si dhe me procedurat standarte të inspektimit referuar objektivave të ISHSH Rajonal, Sektori i Inspektimeve të tjera Shëndetësore ka për qëllim të realizojë detyrat në përputhje me ligjet dhe aktet nënligjore në fuqi, duke përdorur me efikasitet burimet njerëzore.

Sektori i Inspektimeve të tjera Shëndetësore përbëhet nga:

Përgjegjësi i sektorit

Inspektorë stomatolog

Inspektorë për institucionet shëndetësore

Inspektorë për inspektime të tjera

Inspektorët e Sektorit të Inspektimit Sanitar dhe Inspektimeve të tjera Shëndetësore:

- Kryejnë inspektime, sipas përcaktimeve në programimin e inspektimit.
- Zbatojnë procedurat dhe hapat e inspektimit sipas ligjit nr 10 433 datë 16.06.2011 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë” dhe ligjeve e akteve të tjera nën ligjore në fushën e shëndetit publik që janë në fuqi.
- Kryejnë detyrat që u ngarkohen konform legjislacionit në fuqi, në kohë dhe me cilësi si dhe duke respektuar me rigorizitet kërkesat dhe parimet kryesore si objektiviteti, korrektësia, konfidencialiteti, profesionalizmi etj.
- Gjatë ushtrimit të detyrës, ruajnë konfidencialitetin e të dhënave dhe jep informacion vetëm në bazë dhe brenda kufijve të ligjit dhe rregullores të institucionit për mbrojtjen e të dhënave personale dhe të dhënave që lidhen me veprimtarinë tregtare apo profesionale të subjektit të inspektimit apo personave të tjerë.
- Gjatë ushtrimit të kontrollit, janë të detyruar të zbatojnë të gjitha ligjet dhe aktet nënligjore në fuqi si dhe akte të tjera administrative që janë në funksion të veprimtarisë në fushën e inspektimeve.
- Mbajnë lidhje të vazhdueshme me përgjegjës të sektorit dhe i njoftojnë ata për ecurinë dhe problemet që evidentohen gjatë ushtrimit të inspektimit dhe për masat e ndërhyrjet që kërkohen në proces në varësi të këtyre problemeve.
- I kërkojnë përgjegjës të sektorit zgjatjen e afatit të programuar për përfundimin e inspektimit, kur e gjykon të nevojshme dhe e argumenton atë me volum më të madh pune nga parashikimi apo për probleme të ndryshme të dalta gjatë procesit të inspektimit.
- Bazuar në rezultatet dhe dokumentacionin e inspektimit, hartojnë relacion inspektimi, ku pasqyrohen përfundimet e arritura nga inspektimi.
- Marrin dokumenta për sigurimin e provave dhe fotokopje të vërtetuara me origjinalin të dokumentave për veprimet që kanë lidhje me inspektimin që ushtrohet.
- Në përfundim të të gjithë fazave dhe procedurave të kontrollit të çdo subjekti plotësojnë dosjen e kontrollit në inventarin e së cilës evidentohet dhe administratohet i gjithë dokumentacioni i kontrollit sipas kërkesave të përcaktuara.
- Dorëzojnë tek përgjegjësi i sektorit ose një punonjësi të autorizuar prej tij, dosjen e plotësuar si më sipër dhe me shkresën evidentuese për çdo inspektim të përfunduar.
- Mbajnë përgjegjësi ligjore, disiplinore, administrative, sipas rastit, për vërtetësinë dhe saktësinë e rezultateve të punës së tij inspektuese.
- Inspektorët që ngarkohen me shqyrtimin e denoncimeve duhet të marrin cdo informacion dhe dokumentacion të nevojshëm nga përgjegjësi i sektorit dhe për përfundimet e procesit të njoftojnë organet përkatëse dhe subjektin denoncues.
- Marrin masë administrative në rastet e konstatimit të shkejeve ligjore së bashku me inspektorët e tjerë të grupit.
- Përgjigjen para përgjegjës të Sektorit për realizimin e detyrave të ngarkuara.
- Mbajnë përgjegjësi për bazën materiale të praktikave inspektuese.

Gjatë vitit 2018 nga ana e inspektorëve të ISHSH u kryen në total 25 705 inspektime dhe ri-inspektime në të gjithë territorin e vendit.

**INSPEKTIME DHE RI-INSPEKTIME**

QARKU	INSPEKTIME	RI-INSPEKTIME	TË GJITHA
BERAT	1868	205	2073
DIBER	1396	54	1450
DURRES	2233	243	2476
ELBASAN	1670	39	1709
FIER	1809	147	1955
GJIROKASTER	1327	143	1470
KORCE	2097	28	2125
KUKES	1465	81	1546
LEZHE	1293	65	1358
SHKODER	1175	136	1311
TIRANE	4659	1175	5834
VLORE	2278	120	2398
<b>TOTALI</b>	<b>23269</b>	<b>2436</b>	<b>25705</b>

**MASA ADMINISTRATIVE**

QARKU	MASA ADMINISTRATIVE/LEKË	MASA ADMINISTRATIVE/JO NË LEKË
BERAT	5	4 Vendime të Ndërmjetme/1 Vendim Përfundimtar
DIBER	10	10 Vendime të Ndërmjetme
DURRES	50	1 Vendim i Ndërmjetëm
ELBASAN	34	57 Vendime të Ndërmjetme/ 4 Paralajmërimë
FIER	13	3 Vendime të Ndërmjetme/4 Vendime Përfundimtare
GJIROKASTER	14	0
KORCE	12	3 Vendime të Ndërmjetme
KUKES	12	6 Vendime të Ndërmjetme/1 Vendim Mbyllje
LEZHE	7	0
SHKODER	26	2 Vendime të Ndërmjetme
TIRANE	79	10 Vendime të Ndërmjetme
VLORE	43	1 Sekuestro/9 Vendime Përfundimtare
<b>TOTALI</b>	<b>305</b>	<b>96 Vendime të Ndërmjetme/14 Vendime Përfundimtare/4 Paralajmërimë/1 Vendim Mbyllje/1 Sekuestro</b>



Sipas fushës inspektimet e kryera gjatë vitit 2018 janë:

## **INSPEKTIME SPITALORE**

### **OBJEKTIVI**

- Objektivi i inspektimit të kujdesit spitalor është mbrojtja e shëndetit të popullatës përmes procesit inspektues të respektimit të legjislacioneve në fuqi për kujdesin spitalor

### **FUSHAT E ZBATIMI**

- Qendrat Spitalore Universitare.
- Spitalet publike

Inspektorati Shtetëror Shëndetësor ka kryer inspektime në spitale publike gjatë periudhës shkurt - mars 2018. Këto inspektime janë kryer në bazë të Listë Verifikimeve të përgatitura nga ISHSH qendror.

Në total janë kryer 39 inspektime te subjekteve spitalore publike në të gjithë vendin.

### Qëllimi inspektimit:

Monitorimi i aktivitetit dhe evidentimi i problematikës, me qëllim rritjen e cilësisë së ofrimit të shërbimeve shëndetësore dhe standarteve ndaj popullatës, në spitalet publike dhe jo publike

### Objektet e inspektimit:

- Inspektimi i dokumentacionit
- Inspektimi i shërbimit të urgjencës dhe procedurat e pranimit
- Inspektimi i pavionëve.
- Inspektimi i laboratorëve mjekësor dhe ambjenteve ku kryhen ekzaminime imazherike dhe të tjera.
- Inspektimi për shërbimin e obstetrik-gjinekologji ( kur ky shërbim është i përfshirë brenda spitalit ).
- Inspektimi i zbatimit të ligjit nr. 8528, datë 23.09.1999 për nxitjen dhe mbrojtjen e të ushqyerit me gji.
- Inspektimi i zbatimit të Ligjit 9636, datë 06.11.2006, ” Për mbrojtjen e shëndetit nga produktet e duhanit”, i ndryshuar.

### Gjatë inspektimit u evidentuan këto problematika:

- Ambjentet e spitaleve (Dyshemeja, muret, tavanet e dhomave dhe korridoreve, pavjonet, WC-të) dhe ambjente të tjera, janë të amortizuara dhe me lagështirë, nuk kanë kushte higjeno-sanitare të mira.
- Nuk respektohet me rigorozitet procedura e administrimit të sigurt të mbetjeve të rrezikshme spitalore (ndarja e tyre në burim dhe grumbullimi, evadimi dhe eliminimi i tyre).
- Personeli mjekësor i pa paisur me Libreza Shëndetësore.
- Nuk realizohen analizat e ujit të pijshëm.
- Nuk realizohet dezinfektimi e trajtimi i ambjenteve të jashtëme e të brendëshme .
- Nuk ka Akt- Miratim Higjeno-Sanitar.
- Në Shërbimin e Urgjencës procedura e dhënies së ndihmës së parë dhe Triazhimi i pacientëve, nuk kryhej në përputhje me praktikat mjekësore dhe standartet.

## **INSPEKTIVE PËR PROCEDURËN E ADMINISTRIMIT TË SIGURTË TË MBETJEVE SPITALORE**

Inspektorati Shtetëror Shëndetësor gjatë vitit 2018 ka kryer 1248 inspektive dhe 188 riinspektive për procedurën e Administrimit të Sigurtë të Mbetjeve Spitalore në Institucionet shëndetësore publike dhe jo publike.

Inspektimi u përqëndrua në:

- Dokumentacioni tip “Kontratë për administrimin e mbetjeve spitalore” e institucionit shëndetësor prodhues të mbetjeve spitalore me kompanitë e licencuara nga Ministria e Mjedisit.
- Procesi i administrimit të mbetjeve spitalore sipas Udhëzuesit Kombëtar për Administrimin e Sigurtë të Mbetjeve Spitalore si më poshtë:
  - Ndarja në burim, ambalazhimi dhe etiketimi i mbetjeve spitalore
  - Manipulimi dhe magazinimi on-site i mbetjeve spitalore
  - Grumbullimi dhe transportimi i mbetjeve spitalore
  - Trajtimi dhe agjesimi i mbetjeve spitalore
  - Mbajtja e regjistrit

Gjatë inspektimit u evidentuan këto problematika:

- Nuk respektohej me korrektësi e gjithë procedura për administrimin e sigurtë të mbetjeve spitalore.
- Nuk kishte rregullore të brendshme për “Menaxhimin e mbetjeve spitalore”.
- Nuk kishte kontratë me firmë të licensuar për “Evadimin e mbetjeve të rrezikshme spitalore”.
- Kishte mangësi në procedurën e dokumentimit dhe regjistrimit të administrimit të mbetjeve spitalore, sipas kriterëve të përcaktuara.
- Kishte mangësi në krijimin e kushteve të përshtatshme për magazinimin e përkohshëm të Mbetjeve Spitalore.

Plani i punës për shërbimin e Transfuzionit të Gjakut i cili duhet të kryhej në muajt shtator-tetor 2018, nuk është realizuar për arsye të Urdhërit të Inspektorit të Përgjithshëm për të realizuar inspektive të përbashkëta me ISHMP për “Administrimin e mbetjeve spitalore” dhe si rezultat i disa arsyeve objektive.

## **INSPEKTIVE AMBULATORE**

### **OBJEKTIVI**

- Garantim dhe respektim i kërkesave ligjore në fushën e kujdesit ambulator për mbrojtjen e shëndetit të popullatës përmes procesit inspektues të respektimit të legjislativëve në fuqi për kujdesit ambulator.

### **FUSHAT E ZBATIMIT**

- Klinikë mjekësore me një specialitet.
- Klinikë mjekësore me disa specialitete
- Laborator Klinikë-biokimik.
- Laborator mikrobiologjik.
- Laborator Optik.
- Laborator Gjenetik.
- Kabinet imazherik

- Poliklinka dhe shërbimet shëndetësore në varësi të tyre.
- Kabinet mjekësor.
- Qendra mjekësore.

Gjatë vitit 2018 u kryen 782 inspektime dhe 73 ri-inspektime ambulatorë.

Problematika e hasur gjatë inspektimeve konsistonte në:

- Mungesë dokumentacioni higjieno-sanitar (akt-miratim higjieno-sanitar, libreza shëndetësore, DDD, raport analizë uji i pijshëm)
- Mungesën e ambjentesh sipas përcaktimeve në legjislacion
- Prani lagështie.
- Mungesë e lejes së ushtrimit të profesionit

Masa:

- 4 paralajmërime
- 4 masa administrative (mungesë leje ushtrimi profesioni, mungesë libreze shëndetësore, mos realizim detyrash)
- 1 vendim mbyllje

## **INSPEKTIME SANITARE**

### **OBJEKTIVI**

- Kontrolli i zbatimit të të gjitha ligjeve e akteve nënligjore higjieno-sanitare në sektorët shtetërorë, privatë, veprimtaritë e ndryshme të ushtruara nga persona fizikë e juridike, vendas e të huaj të cilët veprojnë në fushat e mëposhtëme të zbatimit.
- Kontroll dhe përgjigje në kohë në situata emergjente për parandalimin e përhapjes së sëmundjeve infektive, duke bërë koordinimin me strukturat e inspektoratit në qarqe.
- Identifikimi i situatave të mundshme të rrezikshme që dëmtojnë shëndetin e punonjësve që janë në kontakt me to, përtej normave të lejuara.

### **FUSHAT E ZBATIMIT**

- Në subjektet e prodhimit, ruajtjes, magazinimit, transportimit e tregëtimit të produkteve të të gjitha llojeve dhe në të gjitha kategoritë e punimeve minerare.
- Në subjektet ku ushtrohen veprimtari socialkulturore, shëndetësore, arsimore dhe kërkimore shkencore.
- Në repartet dhe strukturat në varësi të Ministrisë së Mbrojtjes dhe në ato të Ministrisë së Rendit, në pikat kufitare, portet, aeroportet, doganat, si dhe në mjetet e transportit tokësor, hekurudhor, detar, vendas e të huaj.

Gjatë vitit 2018 u kryen 10 299 inspektime sanitare:

## **INSPEKTIMI I NDËRMARJEVE PËR KUJDESIN DHE SIGURINË E SHËNDETIN NË PUNË**

Gjatë vitit 2018 u inspektuan 593 subjekte për sigurinë e shëndetin në punë.

### **Qëllimi:**

Cilësia e shërbimeve mjeksore që u jepen punëmarrësve në vendin e punës

### Objekti i inspektimit

Të gjitha ndërmarjet ku numri i punonjësve është më pak se 15, si dhe në ato ndërmarje ku marrja në punë e mjekut është e detyrueshme në bazë të legjislacionit në fuqi, pamvarësisht nga numri i tyre.

### Problematika

- Nuk janë vërejtur problematika gjatë inspektimeve të kryera.

## **INSPEKTIME NË SUBJEKTE TË FURNIZIMIT ME UJË TË PIJSHËM**

Gjatë vitit 2018 u kryen 263 inspektime. Subjektet e furnizimit me ujë të pijshëm janë subjekte të rëndësisë së vecantë dhe gjatë vitit 2018 ishin parashikuar të kryeshin 3 herë (si subjekte të sezonit paraturistik, subjekte të sezonit turistik dhe gjatë muajit tetor), janë inspektuar 2 herë sepse inspektimi muajit tetor është anuluar në bazë të Urdhërit nr. 26 datë 21.09.2018 të Inspektorit të Përgjithshëm.

### Qëllimi:

Mbrojtja e shëndetit publik nëpërmjet kontrollit të cilësisë së ujit të pijshëm tij, duke siguruar që uji të jetë i shëndetshëm dhe i pastër.

### Objekti i inspektimit:

Subjektet e furnizimit me ujë të pijshëm (burime uji, kaptazhe, depo uji, stacione pompimi, ujësjellësa, puse etj).

### Problematika:

- Klorinimi nuk kryhet konform legjislacionit në fuqi
- Depo të parrethuara dhe të amortizuara.
- Mos rrespektimi dhe mungesa e rrethimit të zonave të mbrojtjes sanitare
- Lënda dezinfektante ruhet në kushte jo të mira
- Puset kanë mure të dëmtuara
- Rrjet shpërndarës i amortizuar
- Mungesa e kontratës me DSHP për kryerjen e analizave të ujit
- Mungesa e aparatit për dozimin e lëndës dezinfektante
- Mungesë e dezinfektimit e ambienteve të brendëshme
- Depozita e klorit nuk është e vendosur në ambjent të veçantë dhe të izoluar
- Ambientet e personelit në kushte jo të mira higjieno sanitare
- Mungesa e Akt-Miratimit higjieno-sanitar
- Mungesë e dokumentacionit higjieno-sanitar.

## **INSPEKTIME PARA DHE GJATË SEZONIT TURISTIK**

Gjatë vitit 2018 u kryen 6022 inspektime në funksion të sezonit turistik veror.

### Qëllimi:

Inspektimi i zbatimit të ligjeve dhe akteve nënligjore në sektorët shtetërorë, privatë dhe veprimtaritë e ndryshme të ushtruara nga persona fizikë e juridike, vendas e të huaj.

### Objekti:

- Subjektet e akomodimit me fjetje (hotele, motele, hostele, bujtina, hane, resorte, fshatra turistike, kampingje etj)
- Pikat e shitjes dhe të shërbimit të ushqimit të përgatitur (restorant, bar-restorant, Fast-Food, byrektore, piceri, menca, mëngjesore, pasticieri, akulllore, zgarra, birrari etj).
- Bare (bar-kafe, bar-lloto, kazino, pub, disco etj).
- Subjekte të prodhimit, konservimit, përpunimit, ambalazhimit, bluarjes të produkteve ushqimore (fabrika/ punishte/ pika për prodhimin e përpunimin e produkteve të mishit, thertoret, peshkut, bulmetit, turshive, rrecelnave, vajit, kompostos, kripës, miellit, kafesë, prodhimet e brumit, furrat e bukës, pasticieritë, akulloret etj).
- Pikat/ tregjet e shumicës / magazinat ushqimore/ magazinat frigoriferike (tregjet e hapura ose të mbyllura , magazinat ushqimore ose frigoriferike për shitjen me shumicë të mallrave ushqimore, produkteve të mishit, peshkut, fruta-zarzavateve, pijeve alkoolike dhe joalkoolike etj).
- Pikat e shitjeve me pakicë të produkteve ushqimore (dyqane, ushqimore, markete, minimarkete, supermarkete etj)
- Subjektet e furnizimit me ujë të pijshëm (burime uji, kaptazhe, depo uji, stacione pompimi, ujësjellësa, puse etj).
- Subjekte të shërbimeve kozmetike (parukeri, berber, qendra estetike, tataro, masazh etj).
- Subjekte të prodhimit, përpunimit, ambalazhimit të pijeve alkoolike, joalkoolike (fabrika/ linja prodhimi/ ambalazhimi të pijeve alkoolike, pijeve freskuese, ujit të ambalazhuar, kantinat etj.).
- Pishinat.
- Subjektet social kulturore dhe sportive ( Parqet kombëtare, muzetë, kinematë, teatrot, bibliotekat, qendrat social kulturore, palestrat, sallat e kërcimit, etj)

#### Problematika:

- Mungesë e Akt-Miratimit higjieno sanitar.
- Mungesë apo mos rinovim i librezave shëndetësore.
- Mungesë e certifikatës DDD.
- Mungesë e raportit mjeko-ligjor të punonjësve(KML)
- Prani të lagështisë dhe mykut në ambientet e subjektit.
- Mungesë e rjetave të telit në ambientet e përgatitjes së produkteve ushqimore.
- Mungesë e pllakave majolike në anekset hidro sanitare
- Ambiente të palyera në subjekte.

#### Problematika në pishina

- Mungesa e analizës së ujit fiziko-kimike dhe mikrobiologjik e ujit të pishinës.
- Mungesa e rregullores së brendëshme
- Mungesa e regjistrit të monitorimit të ujit të basenit
- Mungesa e personit përgjegjës
- Mungesë e raporteve mjeko ligjore (KML) të punonjësve
- Mungesa apo mosrinovimi i librezave shëndetësore të punonjësve
- Mungesa e një personi të kualifikuar për dhënien e ndihmës së parë.
- Mungesa e dokumentit të vlerësimit të riskut.

**INSTITUCIONE PARASHKOLLORE, SHKOLLORE, INSTITUCIONE TË  
ARSIMIT TË LARTË DHE SUBJEKTE TË AKOMODIMIT DHE SHËRBIMIT TE  
TYRE**

Gjatë vitit 2018 u inspektuan 2248 subjekte. Ky inspektim është kryer në përfundim të vitit shkollor mësimor për evidentimin e parregullsive në këto subjekte dhe lënien e detyrave për korrigjim e tyre, dhe gjatë muajit shtator, për një fillim të mbarë të sezonit të ri mësimor.

### Qëllimi

Inspektimi i zbatimit të ligjeve dhe akteve nënligjore në institucionet arsimore për të siguruar optimumin shëndetësor të kushteve të mësimin, jetesës e shlodhjes si dhe kontrollin në pikat kritike në të gjithë zinxhirin për prodhimin e produkteve ushqimore.

### Objekti:

- Institucionet arsimore parashkollore (publike dhe jopublike)
- Institucionet arsimore shkollore, (publike dhe jopublike)
- Institucionet e arsimit të lartë (publike dhe jopublike)
- Konviktet dhe menecat e institucioneve të arsimit të mesëm dhe të lartë (publike dhe jopublike).

### Problematika në këto subjekte konsistoi:

- Mungesa e dokumentacionit të detyrueshëm higjieno sanitar për subjektin dhe për personelin.
- Amortizim i ndërtesave të shkollave.
- Ka prani të lagështirës në të gjitha ambientet.
- Ka amortizim të bazës materiale të shkollave (banka, karrige etj).
- Gjendje e rënduar e anekseve higjieno-sanitare, dhe e pajisjeve të tyre.
- Aneke hidro sanitare jashtë ambienteve të shkollës ( shkollat e fshatrave)
- Mungesa e palestrës dhe ambienteve sportive në shkolla.
- Mungesa e laboratorëve mësimorë ( shkollat e fshatrave).
- Mosfurnizim me ujë të rrjedhshëm, mungesa e ujit të ngrohtë.
- Amortizim i rrjetit elektrik, mungesë celsash, prizash etj.
- Duke qënë se numri i nxënësve në shkolla është i lartë sipërfaqja në m<sup>2</sup> për nxënës, numri WC-ve dhe lavamanëve është shumë herë më i vogël se normat e lejuara.
- Në institucionet ku shkolla dhe kopshti janë në të njëjtën godinë, vihet re se fëmijët e kopshtit përdorin të njëjtat nyje hidro sanitare me ato të shkollës, gjë që është në kundërshtim me rregulloret higjieno sanitare të ndërtimit të kopshteve, të cilat përcaktojnë specifikën se si duhet të jënë të përshtatura këto ambiente për fëmijët e vegjël.
- Nuk ka ambiente të vecanta magazinimi për ruajtjen e produkteve ushqimore ( kopshte, cerdhe).
- Ka mungesa në pajisjen e bllokut të gatimit në kopshte.
- Mungesa e rrjetave të telit, mbrojtëse ndaj insekteve në dritare ( kopshte, cerdhe).
- Nuk ka ambjent pritës dhe garderoba për fëmijët ( kopshte, cerdhe)..
- Në kopshte mungon parketi në dysheme.
- Nuk ka garderoba për personelin (kopshte, cerdhe).
- Amortizim ose mungesë e pajisjeve larëse në lavanderi( kopshte, cerdhe).
- Tualete të amortizuara në kopshte apo të papërshtatshme për grup moshën.

Me qëllim marrjen e masave urgjente për zhvillimin e një procesi mësimor në kushte optimale raporti i këtij inspektimi me të gjitha problematikat e gjetura ju dërgua:

- Zyrës së Kryeministrit.
- Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

- Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë.
- Kryetarëve të Bashkive.

## **INSPEKTIMI I INSTITUCIONEVE TË EKZEKUTIMIT TË DËNIMIT TË VEPRAVE PENALE DHE TË PARABURGIMIT**

Gjatë vitit 2018 u inspektuan 34 institucione të Ekzekutimit të Dënimit të Veprave Penale dhe të Paraburgimit.

### Qëllimi:

Inspektimi i zbatimit të ligjeve dhe akteve nënligjore për respektimin e kushteve higjieno-sanitare në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale dhe të paraburgimit

### Objekti i inspektimit:

Institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale dhe të paraburgimit.

- Ndërtesat dhe mjediset e jashtme
- Mjediset e brendshme
- Shërbimi mjekësor

### Problematika në IEVP konsistoi:

- Është konstatuar lagështirë e myk në dhomat e të dënuarve.
- Dhomat ishin të mbipopulluara.
- Kushtet në IEVP Lushnjë janë jashtë normave higjieno sanitare.
- Nuk kanë kontratë me subjekte për trajtimin e mbetjeve të rrezikshme spitalore. (1 IEVP ose 3.2%)
- Nuk janë të pajisur me Akt Miratimi higjieno-sanitar një pjesë e institucioneve.

### Problematika në Drejtoritë e Policisë konsistoi:

- Nuk është realizuar si inspektim, për arsye se subjekti nuk është informuar nga institucionet eprore.
- Është konstatuar lagështirë e myk në dhomat e të paraburgosurve.
- Nuk kanë kryer analizën e ujit të pijshëm.
- Nuk kanë kryer shërbimin e DDD.
- Nuk u paraqitën Librezat shëndetësore të personelit në dhomat e izolimit.
- Nuk janë të pajisur me Akt Miratimi higjieno-sanitar.

## **INSPEKTIMI I FIRMAVE APLIKUESE, IMPORTUESE DHE CERTIFIKUESE DDD**

Gjatë vitit 2018 u inspektuan 116 subjekte aplikuese, importuese dhe çertifikuere DDD.

### Qëllimi:

Inspektimi i zbatimit të ligjeve dhe akteve nënligjore nga subjektet e licencuara të cilat importojnë apo ofrojnë shërbimet DDD me qëllim mbrojtjen e shëndetit publik nga organizmat e dëmshëm nëpërmjet përdorimit të sigurtë të lëndëve biocide.

### Objekti i inspektimit:

- Të gjitha subjektet importuese të lëndëve biocide, të cilat përdoren në shëndetin publik.
- Të gjitha subjektet që kryejnë shërbime të produkteve biocide në shëndetin publik.

Problematika në këto subjekte konsistoi:

- Mungesa e regjistrimit të të dhënave për subjektet që marrin shërbimin DDD
- Mosevidentimi në certifikatat e dezinfektimit që u jepen subjekteve, sasia dhe përqëndrimi i lëndëve të përdorura.
- Mungesa e kontratës me drejtuesin teknik.
- Mungesa e regjistrimit për lëndët DDD të tërhequra nga firma importuese
- Mungesa e Akt-Miratimit higjieno sanitar
- Mosplotësim i kushteve të automjeteve të transportit të lëndëve biocide.
- Mosplotësim i kushteve të magazinave të ruajtjes së lëndëve biocide.

Janë kryer 1164 Inspektime të tjera, bazuar në kërkesa për pajisje me Akt-Miratim higjieno sanitar, si dhe inspektime të kryera nga denoncimet dhe ankesat e ndryshme ardhur pranë ISHSH.

Gjatë vitit 2018 janë pajisur me Akt Miratim higjieno sanitar 3584 subjekte

### **INSPEKTIMI I KLINIKAVE MJEKËSORE ESTETIKE JOPUBLIKE DHE QENDRAVE KOZMETIKE DHE ESTETIKE**

Gjatë vitit 2018 u inspektuan 41 subjekte të shërbimeve kozmetike dhe estetike.

Qëllimi:

Rritja e cilësisë së ofrimit të shërbimeve kozmetike dhe estetike ndaj qytetarëve duke rrespektuar të gjitha ligjet dhe aktet nënligjore në fuqi.

Objekti:

- Të gjitha klinikat mjekësore estetike jopublike.
- Të gjitha qendrat e të shërbimeve kozmetike dhe estetike (parukeri, berber, qendra estetike, tatoo, masazh etj).

Problematika në subjektet e shërbimeve kozmetike dhe estetike kozmetike ka konsistuar në mungesën e dokumentacionit higjieno sanitar:

- Mungesë ose mosrindovim i librezave shëndetësore
- Mungesë e Akt-Miratimit higjieno sanitar
- Moskryerja e shërbimit DDD
- Mungesë e raportit analizës së ujit të pijshëm
- Mungesa të raportit mjeko ligjor të punonjësve.

### **INSPEKTIME PËR ZBATIMIN E LIGJIT NR. 9928 PËR SHËRBIMIN SHËNDETËSOR STOMATOLOGJIK” TË NDRYSHUAR.**

U inspektuan:

- Kabinetet dentare publike dhe jo publike
- Laboratorët dentare

Gjatë vitit 2018 u kryen 1918 inspektime.

Problematika e hasur gjatë inspektimeve ishte kryesisht në:

- Mungesën e lejeve të ushtrimit të profesionit (UMSH-USSH)
- Mungesën e kontratave për evadimin e mbetjeve spitalore



- Mungesën në dokumentacion (Lib. Shendetësore, Akt-Miratimeve higjeno-sanitare, certifikata DDD)

### **INSPEKTIME PER ZBATIMIN E LIGJIT NR. 8528 “PËR NXITJEN DHE MBROJTJEN E TË USHQYERIT ME GJI” TË NDRYSHUAR.**

Në zbatim të Planit të Punës 2018 të Inspektoratit Shtetëror Shëndetësor për monitorimin e zbatimit të Ligjit 8528 i datës 23.09.1999 “Për nxitjen dhe mbrojtjen e të ushqyerit me gji” të ndryshuar, gjatë vitit 2018 në të gjithë vendin u kryen 116 inspektime

Inspektimi u përqëndrua në:

- Etiketën në gjuhën shqipe
- Reklamimin në media
- Promocionin spitale, qendra shëndetësore, farmaci, klinika gjinekologjike etj.

### **INSPEKTIME PER ZBATIMIN E LIGJIT NR. 9942 DATË 26.06.2008 “PËR PARANDALIMIN E ÇRREGULLIMEVE TË SHKAKTUARA NGA AMJAFTUESHMËRIA E JODIT NË ORGANIZMIN E NJERIUT” TË NDRYSHUAR.**

